



Energy Regulatory Office  
Zyra e Rregullatorit për Energji  
Regulatorni Ured za Energiju

Hamdi Mramori Street, No 1

Prishtina 10000 – Kosovo

Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103

Fax: +381 (0) 38 247 620

e-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org)

[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

# Zyra e Rregullatorit për Energji Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Kushtet e Përgjithshme</b>	<b>1</b>
<b>1.1</b>	<b>Shtrirja dhe qëllimi</b>	<b>1</b>
<b>1.2</b>	<b>Amendamentet</b>	<b>2</b>
<b>1.3</b>	<b>Përkufizimet dhe interpretimet</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Përgatitja dhe dorëzimi i llogarive rregullatore</b>	<b>4</b>
<b>2.1</b>	<b>Detyrimi për të dorëzuar llogaritë rregullatore</b>	<b>4</b>
<b>2.2</b>	<b>Afati kohor dhe forma e dorëzimit</b>	<b>4</b>
<b>2.3</b>	<b>Verifikimi dhe kontrollimi (auditimi)</b>	<b>5</b>
<b>2.4</b>	<b>Botimi (Publikimi)</b>	<b>6</b>
<b>3</b>	<b>Formati i llogarive rregullatore</b>	<b>7</b>
<b>4</b>	<b>Parimet dhe politikat rregullatore të kontabiliteteve</b>	<b>8</b>
<b>4.1</b>	<b>Parimet e përgjithshme</b>	<b>8</b>
<b>4.2</b>	<b>Ndarja e aktiviteve</b>	<b>8</b>
<b>4.3</b>	<b>Vlerësimi dhe rivlerësimi i aseteve</b>	<b>9</b>
<b>4.4</b>	<b>Ndarja e aseteve</b>	<b>9</b>
<b>4.5</b>	<b>Subvencionet dhe asetet e financuara nga koncesionet</b>	<b>10</b>
<b>4.6</b>	<b>Shpenzimet Kapitale dhe shtesat</b>	<b>10</b>
<b>4.7</b>	<b>Kapitalizimi</b>	<b>11</b>
<b>4.8</b>	<b>Zhvlerësimi (Amortizimi)</b>	<b>11</b>
<b>4.9</b>	<b>Kostot, të ardhurat vjetore, asetet dhe alokimi i detyrimeve</b>	<b>13</b>
<b>4.10</b>	<b>Transaksionet e palës së përfshirë</b>	<b>12</b>

# 1 Dispozitat e Përgjithshme

## 1.1 Shtrirja dhe Qëllimi

1.1.1 Këto Udhëzime e Kontabilitetit për Rregullatorin, janë nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në mënyrë që të krijojnë një mekanizëm që ZRRE-ja të mbledhë prej të licencuarve informacione financiare dhe të tjera që nevojiten për qëllime të rregullatorit, më së tepërmi për përcaktimin e të ardhurave vjetore të mbuluara nga tarifat e rregulluara të faturuara nga të licencuarit..

1.1.2 Neni 13 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë siguron që ZRRE-ja të ketë:

Të drejtën t'i kërkojë çdo ndërmarrjeje energjetike ose autoriteti publik, informacione, të dhëna dhe dokumente, përfshirë edhe informacionet e fshehta, që janë të nevojshme për plotësimin e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të veta.

1.1.3 Ky autoritet përforcohet përmes kushteve të licencës dhe, në veçanti, përmes kriterëve të të licencuarve për të përgatitur dhe mbajtur llogari të veçanta për biznese të veçantë, si vijon:

2. I licencuari do të përgatisë llogaritë vjetore në përputhje me Udhëzimet e Kontabilitetit të Rregullatorit të nxjerra prej ZRRE-së, dhe do t'i dorëzojë një kopje ZRRE-së të llogarive vjetore të kontrolluara (audituar ose revizuara), të përgatitura sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të periudhës me të cilën kanë të bëjnë llogaritë.
3. I Licencuari, pa paragjykuar ndaj paragrafit 2, në kontabilitetin e tij do të mbajë ose do të bëjë të mundur mbajtjen, e llogarive për biznesin e plotë [për të licencuarin], dhe në rast se ky kërkohet herë pas here nga ZRRE-ja, do t'i dërgohet kësaj të fundit me formatin dhe në kohën e specifikuar nga vetë ajo. Llogaritë do të jenë në përputhje me Udhëzimet për Kontabilitetin e Rregullatorit pasi mund të nxirren nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
4. Udhëzimet për Kontabilitetin e Rregullatorit, ose direktivat që ZRRE-ja i ka njoftuar të Licencuarit sipas paragrafit 2, mes të tjerash, mund të:
  - (a) Specifikojnë formën e raporteve të bilancit financiar/regjistrave financiarë, por që nuk kufizohen vetëm nga llogaritë e përfitimit dhe humbjes, bilancet e gjendjeve, bilancet financiare e njohura të fitimeve dhe humbjeve, gjendjet e rrjedhjeve të parave , dhe gjendjen e shumave të çdo të ardhure , kostot, asetet, detyrimet, rezervat ose detyrime që janë paguar nga ndonjë biznes ose i janë paguar ndonjë biznesi tjetër, ose që janë përcaktuar përmes shpërndarjes (alokimit) apo caktimit të parave midis biznesit të konsoliduar [të të licencuarit] dhe ndonjë biznesi tjetër.
  - (b) Specifikojnë natyrën dhe përmbajtjen e bilanceve financiare/regjistrave financiarë, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave, kostove, aseteve ose detyrimeve, dhe informacione që kanë të bëjnë me të ardhurat vjetore, kostot, asetet dhe detyrimet në lidhje me aktivitete të specifikuar.
  - (c) Specifikojnë parimet kontabile (përfshirë bazat për shpërndarjen e kostove dhe zhvlerësimin në bazë të kërkesës së rregullatorit).

1.1.4 Këto **udhëzime**:

- Përcaktojnë procesin për plotësimin dhe dorëzimin e **llogarive rregulatore** nga ana e të licencuarve në përputhje me këto **udhëzime**;

- Detajojnë informacionin që duhet të përfshihet në **Ilogaritë rregullatore**;
- Shpjegojnë se si të licencuarit duhet të përgatisin **Ilogaritë e tyre rregullatore**, dhe në veçanti parimet që duhet të udhëheqin shpërndarjen e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve dhe detyrimeve ndërmjet bizneseve, aktiviteteve dhe funksioneve të të licencuarve.

1.1.5 Informacioni që i jepet ZRRE-së në përputhje me këtë kriter dhe këto UKR, do të përdoren për qëllimet vijuese:

- Për të siguruar shpërndarjen e korrekte të të ardhurave , shpenzimeve dhe aseteve midis aktiviteteve të rregulluara dhe të parregulluara;
- Për të definuar dhe të përjashtoj shpenzimet të cilat nuk mund të kontrollohen;
- Për të dhënë informatë përkatëse ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara për të licencuarit , dhe shqyrtimin e tarifave të rregulluara që i janë propozuar ZRRE-së nga të licencuarit;
- Për të matur përmbushjen reale të ndërmarrjeve energjetike për sa i përket ariturve financiare kundrejt atyre të parashikuara;
- Për të marrë dhe publikuar informacionet mbi përmbushjen e ariturave financiare të të licencuarve; dhe
- Qëllime të tjera që mund të nevojiten për realizimin e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të ZRRE-së.

## 1.2 Ndryshimet (amendamentet)

1.2.1 ZRRE-ja kohë pas kohe, do të ndryshojë këto **udhëzime** në mënyrë që të përgjigjet ndryshimeve të nevojshme. Ndërsa bën ndryshime të tilla, ZRRE-ja do të sigurojë mundësitë e përshtatshme për konsultim me të licencuarit dhe palë të tjera të interesuara, ku në përgjithësi përfshihen:

- Botimi i një njoftimi nga ana e ZRRE-së se po synon të ndryshojë këto **udhëzime**;
- Ftohen dhënia e informacioneve, përfshirë komentet me shkrim dhe konsultime me të licencuarit si dhe palë të tjera të interesuara, dhe lejohet një periudhë e arsyeshme kohe për sigurimin e këtyre informacioneve;
- Përgatitja dhe botimi i një drafti të ndryshimeve të propozuara për marrjen e komenteve, duke marrë parasysh informacionet e marra; dhe
- Duke marrë parasysh komentet e marra për finalizimin e ndryshimeve.

## 1.3 Përkufizimet dhe interpretimet

1.3.1 Termat vijues të përdorur në këto **udhëzime** do të kenë kuptimet vijuese:

- **“raporti i auditorëve ndaj rregullatorit”** është raporti i përgatitur në përputhje me nën-seksionet 2.3.3 të këtyre udhëzimeve;
- **“aktivitetet e përjashtuara”** ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.2.3 të këtyre udhëzimeve;

- “**udhëzime**” janë këto Udhëzime të Kontabilitetit të Rregullatorit;
- “**asetet përkatëse të ngarkesës në funksion**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.4.4 të këtyre udhëzimeve;
- “**shpenzimet kapitale të projekteve kryesore**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.6.1 të këtyre udhëzimeve;
- “**asete funksionuese që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.4.4 të këtyre udhëzimeve;
- “**asete jo-funksionuese**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.4.3 të këtyre udhëzimeve;
- “**asete funksionuese**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.4.3 të këtyre udhëzimeve;
- “**pro-forma e raportit të bilancit rregullator financiar**” janë shabllonet që përfshihen në Shtojcën A.1 të këtyre udhëzimeve;
- “**aktivitetet e rregulluara**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.2.2 të këtyre udhëzimeve;
- “**parimet dhe politikat e kontabilitetit të rregullatorit**” janë parimet dhe politikat e përcaktuara në pjesën 4 të këtyre udhëzimeve;
- “**llogaritë rregullatore**” janë bilancet financiare dhe dokumentacioni shoqërues i të licencuarit, që është përgatitur dhe dorëzuar në përputhje me nën-seksionin 2.2.5 të këtyre udhëzimeve;
- “**pala/ët e përfshira**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.10.1 të këtyre udhëzimeve;
- “**artikull i rëndësishëm i alokuar**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.9.5 të këtyre udhëzimeve;
- “**transaksion i rëndësishëm i palës së përfshirë**” ka kuptimin e përcaktuar në nën-seksionin 4.10.6 të këtyre udhëzimeve;
- “**parime dhe politika statutore të kontabilitetit**” janë parimet dhe politikat e aplikuara në përgatitjen e financave statutore; dhe
- “**llogaritë statutore**” janë llogaritë financiare të të licencuarit që janë përgatitur dhe dorëzuar në përputhje me ligjet kosovare<sup>1</sup>;

1.3.2 Termat vijues të përdorur në këto **udhëzime** do të kenë kuptimet e specifikuar në Rregullin mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe në Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike, si dhe në vendimet e nxjerra nga ZRRE-ja sipas këtij Rregulli dhe në përputhje me këtë metodologji:

- “treguesi i inflacionit”;
- “të ardhurat vjetore të lejuara maksimale”;

---

<sup>1</sup> Standardet Kosovare të auditimit janë të bazuara në standardet Internacionale të Kontabilitetit. Sipas rregullores 2001/30, Standardet internacionale të Auditimit janë të aplikueshme në auditimet statutore në Kosovë.

- “kontroll i çmimit”;
- “periudha e kontrollit të çmimit”; dhe
- “baza e aseteve rregullatore”.

1.3.3 Termat e tjerë në këto **udhëzime** do të kenë kuptimet e specifikuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Ligjin mbi Energjinë ose në Ligjin mbi Energjinë Elektrike.

## 2 Përgatitja dhe dorëzimi i llogarive rregullatore

### 2.1 Detyrimi për të dorëzuar llogaritë rregullatore

2.1.1 Të Licencuarit janë të detyruar të përgatisin dhe dorëzojnë **llogari rregullatore**, në përputhje me kushtet e aplikueshme të licencës së tyre dhe në përputhje me këto **udhëzime**.

2.1.2 Nëse ZRRE-ja mendon se kriteri i licencës për dorëzimin e llogarive rregullatore, do të:

- Imponojë kosto të paarsyeshme mbi të licencuarin në fjalë; ose
- Nuk do të rriste në mënyrë domethënëse aftësinë e ZRRE-së për të plotësuar funksionet dhe detyrat e veta;

Atëherë me anë të një njoftimi, ZRRE-ja do ta lironte të licencuarin në fjalë nga ky detyrim, për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, siç është përmendur në njoftim.

2.1.3 Pavarësisht nga periudha që përmban njoftimi i lëshuar në përputhje me nën-seksionin 2.1.2, ZRRE-ja me anë të një njoftimi, mund të heqë këtë lirim në çdo kohë.

2.1.4 Në përgjithësi, të licencuarit që i përkasin kategorive vijuese, nuk do të lirohen nga detyrimi për të dorëzuar llogaritë e rregulluara:

- Të licencuarit që iu është kërkuar t'i propozojnë ZRRE-së tarifat e rregulluara për aprovim; dhe
- Të licencuarit të cilët pavarësisht nëse tarifat e ngarkuara janë të rregulluara apo jo, mbajnë një pozicion dominant në një ose më shumë aktivitete të energjisë.

### 2.2 Koha dhe forma e dorëzimit

2.2.1 **Llogaritë Rregullatore** do të përgatiten në bazë të vitit kalendarik, përveç në rast se njoftohet ndryshe nga ZRRE-ja.

2.2.2 Në rast se një i licencuar fillon veprimet ose përndryshe, detyrohet të përgatisë **llogaritë rregullatore** në një datë tjetër përveç 1 janarit, atëherë **llogaritë fillestare rregullatore** do të mbulojnë periudhën prej datës së detyrimit, deri më 31 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik. **Llogaritë pasuese rregullatore** do të fillojnë prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

2.2.3 **Llogaritë Rregullatore** do të dorëzohen jo më vonë se [tre] muaj pas plotësimit të vitit kalendarik në të cilin aplikohen, në formë elektronike dhe në kopje të printuar të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i të licencuarit dhe nga kontrolli (auditor-revizioni) i tij, të cilët janë emëruar në përputhje me nën-seksionin 2.3.2 më poshtë.

2.2.4 **Llogaritë rregullatore** do të përgatiten në përputhje me parimet dhe politikat e kontabilitetit, të cilat përdoren për të përgatitur **llogaritë statuto** të të licencuarit, dhe **parimet dhe politikat e kontabilitetit të rregullatorit**, të përcaktuara në këto **udhëzime**.

2.2.5 **Llogaritë që i dorëzohen rregullatorit**, do të përfshijnë:

- **bilancet e përfunduara pro-forma të kontabilitetit të rregullatorit**, duke përdorur formatin e përfshirë në Shtojcën A.1
- Një deklaratë të **parimeve dhe politikave domethënëse rregullatore të kontabilitetit të**, të cilat janë përdorur për të përgatitur **llogaritë rregullatore**, të cilat mund të jenë plotësuese ose në zëvendësuese të **parimeve dhe politikave të kontabilitetit**, që janë përdorur për të përgatitur **llogaritë statutores** të të licencuarit dhe **parimet dhe politikat rregullatore të kontabilitetit** që janë përcaktuar në këto udhëzime;
- Një kopje të llogarive statutores më të fundit të të licencuarit dhe raportin shoqërues të auditorëve; dhe
- Një raport të auditorit për rregullatorin mbi llogaritë rregullatore, siç përshkruhet në nën-seksionin 2.3.3, më poshtë.

2.2.6 Informacioni që përmbahet në **llogaritë rregullatore** dhe në dokumentet shoqëruese, do të paraqitet në mënyrën më të kuptueshme të mundur, që të mund të kuptohet pa sakrifikuar kuptueshmërinë ose besueshmërinë e tij.

2.2.7 Nëse **llogaritë rregullatore** dhe materialet shoqëruese që janë dorëzuar, nuk janë të plota, këto do të refuzohen dhe do t'i kthehen të licencuarit për të bërë plotësimin dhe ri-dorëzimin e tyre. ZRRE-ja do të lejojë një periudhë të arsyeshme kohe prej jo më pak se [20] ditësh, për plotësimin e dokumenteve.

2.2.8 ZRRE-ja mund të kërkojë përgatitjen dhe dorëzimin e **llogarive rregullatore** në kohë të ndryshme dhe që të mbulojnë periudha të tjera, të cilat i mendon si të nevojshme për të mbështetur plotësimin e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të tyre. Duke bërë këtë, ZRRE-ja do të lejojë një periudhë të arsyeshme për përgatitjen e këtyre llogarive dhe nuk do të kërkojë që ato të kontrollohen apo të shoqërohen nga **llogari statutores** dhe nga **raporti i auditorit për rregullatorin**.

## 2.3 Verifikimi dhe auditimi (kontrollimi)

2.3.1 I licencuari mirëmban dhe bënë përgatitje të kontabilitetit dhe të raportimit, të cilat:

- Mundësojnë përgatitjen e llogarive rregullatore; dhe
- Lejojnë verifikimin e informacioneve të **llogarive rregullatore** duke iu referuar **llogarive statutores**.

2.3.2 Informacioni i siguruar në **llogaritë rregullatore** duhet të kontrollohet në mënyrë të përshtatshme dhe të pavarur prej një auditori të pranuar dhe aprovuar nga ZRRE-ja. I licencuari ka për përgjegjësi që të sigurojë që ky aprovim të merret përpara përgatitjes dhe dorëzimit të **llogarive të rregullatorit**.

2.3.3 Auditori duhet të përgatisë një raport rregullator të auditorëve i cili do të dorëzohet në ZRRE, së bashku me llogaritë rregullatore, siç përcaktohet në nën-seksionin 2.2.5. Ky raport duhet të japë mendimin e auditorit nëse llogaritë rregullatore japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të kostove, të ardhurave vjetore, aseteve dhe detyrimeve të aktiviteteve të rregulluara të të licencuarit, në përputhje me parimet e përcaktuara në këto udhëzime, dhe, në veçanti, duhet të tërheqë vëmendjen e ZRRE-së rreth:

- Ndonjë mangësi në regjistrat e kontabilitetit të të licencuarit, që mund të bëjë të pasigurt besueshmërinë në informacionet që përmbajnë llogaritë rregullatore;



- Ndonjë devijimi domethënës të aplikuar në përgatitjen e **llogarive rregullatore** prej **parimeve dhe politikave të llogarive rregullatore**, që janë përcaktuar në këto Udhëzime; dhe
- Ndonjë çështjeje tjetër që mund të nënkuptojë se **llogaritë rregullatore** nuk kanë dhënë një pasqyrim të vërtetë dhe të drejtë të shpenzimeve, të ardhurave , aseteve dhe detyrimeve të **aktiviteteve të rregulluara** të të licencuarit.

2.3.4 Sigurimi i **raportit të auditorit ndaj rregullatorit** nuk heq detyrimin e të licencuarve që janë përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e **llogarive rregullatore**. Auditorit në asnjë mënyrë nuk i kërkohet që të marrë më shumë përgjegjësi sesa i licencuari, në lidhje me gabimet ose mangësitë që bëhen në **llogaritë rregullatore**, përveç rastit kur është pritur që këto gabime ose mangësi të identifikohen dhe priten gjatë kontrollit të drejtuar sipas të njëjtave standarde të kontrollit të **llogarive statutoe**.

2.3.5 Shablloni për raportin e auditorit ndaj rregullatorit, jepet në Shtojcën A.2.

2.3.6 Ky **raport i auditorit ndaj rregullatorit**, bëhet përveç raporteve ose mendimeve të tjera që janë kërkuar të dorëzohen me **llogaritë statutoe** të të licencuarit.

2.3.7 I Licencuari duhet të marrë masat e duhura që ZRRE-ja të kërkojë prej auditorit shpjegime ose sqarime të mëtejshme në lidhje me **raportin e auditorit ndaj rregullatorit**, si dhe informacione të mëtejshme mbi çështjet që mbulohen nga ky raport. Këto kritere i nënshtrohen parimit se ato nuk duhet të vendosin detyrime të paarsyeshme ndaj auditorit.

## 2.4 Botimi (Publikimi)

2.4.1 **Llogaritë rregullatore** të të licencuarve do të botohen nga ZRRE-ja në faqen elektronike zyrtare, me përjashtim të:

- detajeve të transaksioneve midis të licencuarit dhe **palëve të përfshira**;
- detajeve të parimeve dhe përlllogaritjeve të aplikuara në shpërndarjen (alokimin) e kostove, të ardhurave , aseteve dhe detyrimeve të të licencuarit midis aktiviteteve të tij;
- materialeve të tjera të dorëzuara nga i licencuari, të cilat janë identifikuar si të fshehta nga aspekti komercial dhe janë pranuar si të tilla nga ZRRE-ja.

2.4.2 Të Licencuarit duhet të tërheqin vëmendjen e konsumatorëve me anë të vënies në dispozicion të **llogarive rregullatore** të botuara, në mënyrë sa më të përshtatshme për të siguruar këtë vetëdijesim.

### 3 Formati i llogarive rregullatore

3.1.1 Llogaritë rregullatore synojnë t'i lejojnë ZRRE-së marrjen e informacioneve financiare, në një format të përshtatshëm, në veçanti për:

- Të shqyrtuar përputhshmërinë e të ardhurave që janë fituar nga i licencuari përmes **aktiviteteve të rregulluara**, me anë të kontrollit nga ZRRE-ja mbi të ardhurat , si dhe me cilat do tarifatat të rregulluara të aprovuara nga ZRRE-ja;
- T'u siguruar se i licencuari nuk po shpërndan (alokon) shpenzime, të ardhura, asete dhe detyrime në mënyrë të papërshtatshme, midis **aktiviteteve të rregulluara** dhe **aktiviteteve të përjashtuara nga rregullimi**, dhe brenda aktiviteteve të veta të rregulluara, në një mënyrë që krijon pagesa të cilat nuk pasqyrojnë shpenzimet e aktiviteteve të rregulluara, ose që po fusin ndër-subvencione midis klasave të konsumatorëve; dhe
- Të krahasuar në mënyrë të qëndrueshme, shpenzimet e të licencuarve që sigurojnë **aktivitete të rregulluara** me kostot e këtyre aktiviteteve gjatë viteve të tjerë, si dhe me shpenzimet e të licencuarve të tjerë që ofrojnë të njëjtat **aktivitete të rregulluara**.

3.1.2 **Llogaritë rregullatore** prandaj, duhet të paraqesin informacionin financiar në një format që lejon:

- Dallimin e dukshëm të kostove, të ardhurave vjetore, aseteve dhe borxheve mes **aktiviteteve të rregulluara** të të licencuarit dhe **aktiviteteve të përjashtuara nga rregullimi**;
- Shqyrtimin e pagesave ose çmimeve të transferimit midis **aktiviteteve të rregulluara** të të licencuarit dhe **aktiviteteve të përjashtuara nga rregullimi**, të aplikuara në transaksionet midis të licencuarit dhe kompanive të bashkuara, të shqyrtuara dhe që pasqyrojnë shpenzimet që bëhen gjatë dhënies së shërbimeve; dhe
- Verifikimin e shpërndarjes (alokimit) të kostove, të ardhurave, aseteve dhe detyrimeve, midis kategorive, dhe identifikimin e bazës së këtij alokimi (shpërndarjeje).

3.1.3 **Llogaritë rregullatore** duhet të sigurojnë edhe një pajtueshmëri me **llogaritë statutores** të të licencuarit, duke treguar vlerën përshtatëse që nevojitet për përputhjen e **llogarive rregullatore** dhe **llogarive statutores**.

3.1.4 Formati i **deklaratave pro-forma të kontabilitetit të rregullatorit** do të dorëzohet nga ana e të licencuarve, si pjesë e llogarive rregullatore, siç thuhet në Shtojcën A.1.

## 4 Parimet dhe Politikat rregullatore të kontabilitetit

### 4.1 Parimet e përgjithshme

- 4.1.1 ZRRE-ja ka si synim që të licencuarit të jenë të aftë të përgatisin **llogarit rregullatore** së bashku me përgatitjen e **llogarive të tyre statutore** me kosto minimale shtesë.
- 4.1.2 Në pajtim me këtë dhe sipas kriteve të vendosura në këto **udhëzime**, nëse është e mundur, **parimet dhe politikat rregullatore të kontabilitetit** të aplikuara nga të licencuarit, duhet që të jenë në përputhshmëri me **Standardet Kosovare të Kontabilitetit**.
- 4.1.3 Gjatë përgatitjes së **llogarive rregullatore**, të licencuarit duhet të raportojnë thelbin e transaksioneve, dhe jo formën ligjore në rast se këto të dyja ndryshojnë. Gjatë përcaktimit të thelbit, i licencuari duhet të marrë parasysh pritshmërinë dhe motivimin për një transaksion. Transaksionet individuale që arrijnë ose janë të hartuara për të arritur efekt komercial të përbashkët, do të trajtohen në total.

### 4.2 Ndarja (copëzimi) i aktiviteteve

- 4.2.1 Në përputhje me qëllimet për të cilat janë përgatitur llogaritë rregullatore, të licencuarit duhet të ndajnë (copëzojnë) të ardhurat vjetore, kostot dhe asetet e raportuara në llogaritë e tyre rregullatore, midis **aktiviteteve të rregulluara** dhe **aktiviteteve të përjashtuara nga rregullimi**.
- 4.2.2 **Aktivitetet e rregulluara** janë ato aktivitete që ofrohen si shërbim publik me tarifa të rregulluara, siç përcaktohet në Ligjin mbi Energjinë Elektrike dhe në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë. Duke iu nënshtruar këtyre ligjeve, këto aktivitete përcaktohen për qëllimin e **llogarive rregullatore**, siç janë:
- Shitja e energjisë elektrike prej prodhuesve publikë (siç përcaktohet në Nenin 8 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike) ndaj furnizuesit publik.
  - Shitja e energjisë elektrike prej furnizuesit publik tek konsumatorët jo-të kualifikuar.
  - Transporti i energjisë elektrike nga rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe përmes linjave të ndërlidhjes, përfshirë sigurimin e asetëve të nevojshme për këtë qëllim dhe vënien në funksion të këtyre rrjeteve.
  - Kyçja e konsumatorëve, qofshin ata të privilegjuar ose jo, në rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes.
  - Funksionimi i tregut të energjisë me shumicë.
- 4.2.3 Të gjitha aktivitetet e tjera konsiderohen si **aktivitete të përjashtuara nga rregullimi** për qëllimin e këtyre **llogarive rregullatore**, përveç në rast se ZRRE-ja njofton ndryshe.
- 4.2.4 Në rast se të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet nuk mund të përfshihen ekskluzivisht as në **aktivitetet e rregulluara**, e as në **aktivitetet e përjashtuara nga rregullimi**, atëherë ato duhet të alokohen në përputhje me parimet e përcaktuara në seksionin 4.9.

- 4.2.5 Të licencuarit duhet të identifikojnë vetëm ato kosto që janë të lidhura drejtpërdrejt me shpenzimet operative të aktivitetit të licencuar dhe ato që përbëjnë një pjesë të kostove të përbashkëta dhe të zakonshme të **palëve të përfshira**, të cilat i alokohen të licencuarit.

### 4.3 Vlerësimi dhe rivlerësimi i aseteve

- 4.3.1 ZRRE-ja synon të përcaktojë të ardhurat të lejuara maksimale në çdo periudhë kontrolli në afatet reale, dhe t'i pajtoj ato brenda periudhës së kontrollit të çmimit duke iu referuar një treguesi të inflacionit të definuar nga ZRRE-ja. Në përputhje me këtë, ZRRE-ja do të rikrijojë bazën e aseteve rregullatore në fillim të çdo periudhe të kontrollit të çmimit, duke marrë parasysh inflacionin gjatë periudhës paraprake të kontrollit të çmimit, si dhe zhvlerësimin (amortizimin) e lejuar, shtesat dhe heqjet që janë bërë gjatë asaj periudhe.
- 4.3.2 Në përputhje me këtë, për qëllimet e **llogarive rregullatore**, të licencuarit do të rikrijojnë vlerën hapëse të bazës së aseteve të rregullatorit në fillim të çdo periudhe të kontrollit të çmimit, duke përdorur bazën e asetit rregullator që ka aprovuar ZRRE-ja si vlerë hapëse për atë periudhë.
- 4.3.3 Brenda çdo periudhe të kontrollit të çmimit, të licencuarit gjatë çdo viti do të përcaktojnë bazën hapëse të asetit të rregullatorit që do të konsiderohet si baza përmbyllëse e asetit të rregullatorit për vitin paraprak, e cila është plotësuar me informacione nga rregullimi i inflacionit me anë të përdorimit të treguesit që ka njoftuar ZRRE-ja për këtë qëllim. Ky rregullim inflacioni dhe vlera e treguesit do të identifikohen **në llogaritë rregullatore**.
- 4.3.4 Pagesat e dëmtimit që përfshihen në **llogaritë rregullatore**, mund të lejohen kur vlera luhatëse (ndryshuese) e një asetit në bazën e asetit të rregullatorit, ndryshon dukshëm nga vlera në përdorim. Të licencuarit do të propozojnë që ZRRE-ja të aprovojë çdo pagesë për dëmtim, përpara se ato të përfshihen në **llogaritë rregullatore**.
- 4.3.5 Sipas këtyre kritereve, të licencuarit nuk do të ndërmarrin asnjë rivlerësim të bazës së aseteve të rregullatorit pa lejen e ZRRE-së ose pa drejtimin e ZRRE-së.

### 4.4 Ndarja (copëzimi) i aseteve

- 4.4.1 Duke përcaktuar të ardhurat maksimale të lejuara që duhet të mbulohen nga të licencuarit dhe përmes aprovimit të tarifave të rregulluara, ZRRE-ja synon të bëjë dallimin midis aseteve të blera përpara 1 janarit 2006, ("asetet përpara vitit 2006") për të cilat nuk ekziston asnjë borxh shoqëruar, dhe atyre të blera më 1 janar 2006 ("asetet pas vitit 2006"), ose pas kësaj date. Për këtë qëllim, të licencuarit janë të detyruar të bëjnë dallimin midis këtyre aseteve në përgatitjen e **llogarive të tyre rregullatore** në lidhje me bazën e aseteve të rregullatorit, zhvlerësimin (amortizimin) dhe mbetjet.
- 4.4.2 Të licencuarit janë gjithashtu të detyruar të alokojnë shpenzimet e mirëmbajtjes midis atyre të shoqëruara me asetet para-2006-ës dhe pas-2006-ës. Kjo bëhet për të lehtësuar miratimin e mundshëm që ZRRE-ja mund t'i bëjë pagesës së rinovimeve të infrastrukturës në lidhje me asetet para-2006, në vend të fondit të zhvlerësimit (amortizimit). Në rast se është e pamundur të bëhet një alokim më i përshtatshëm, duke bërë këto lloj alokimesh, të licencuarit do ta lidhin këtë me vlerën e pa-amortizuar të inflacionit të rregulluar për asetet përkatëse, siç është regjistruar për qëllimet e **llogarive staturore**.

4.4.3 Në mënyrë që të ndihmojë ZRRE-në për të monitoruar shkallën në të cilën janë justifikuar shpenzimet kapitale nga ana e të licencuarve, **llogaritë rregullatore** u vënë kusht të licencuarve që të alokojnë shpenzimet kapitale, zhvlerësimin (amortizimin), shtesa dhe mbetjet e asetëve midis:

- **Aseteve funksionuese**, përfshirë ato asete që nevojiten drejtpërdrejt për dhënien e shërbimeve nga i licencuari.
- **Asetet jo-funksionuese**, përfshirë ato asete që mbështesin dhënien e shërbimeve nga i licencuari.

4.4.4 **Asetet funksionuese** kategorizohen më tej sipas qëllimit:

- **Asetet funksionuese që kanë të bëjnë me ngarkesën** janë ato të shoqëruara me kyçjen e kërkesës së re ose prodhimin në sistemin ekzistues.
- **Asetet funksionuese që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën** janë ato asete që shoqërohen me rritjen e besueshmërisë ose cilësisë së furnizimit në sistemin ekzistues, pavarësisht nëse është bërë kyçja e kërkesës së re ose prodhimit. Më tej, këto asete dallohen nga funksioni i tyre parësor, qofshin këto asete prodhimi, asete që kanë të bëjnë me rrjetin, me kontrollin dhe funksionimin e sistemit, si dhe asete të tjera.

4.4.5 ZRRE mund të mos kërkohet kategorizim të tillë, që të aplikohet fillimisht, atëher kur konsideron se të dhënat ekzistues të kontabilitetit nuk janë në gjendje të japin informatat e nevojshme.

4.4.6

4.4.7 **Asetet jo-funksionuese** dallohen prej llojit të tyre parësor, qofshin asete të Teknologjisë Informatike IT, blerjes së tokës dhe ndërtesave për qëllime administrative, qofshin automjete ose edhe asete të tjera.

## 4.5 Fondet dhe asetet e financuara nga koncesionet

4.5.1 ZRRE-ja synon të përcaktojë një kosto kapitali për të licencuarit, me supozimin se asetet financohen me kushte komerciale. Sidoqoftë, ZRRE-ja njih edhe se një pjesë e asetëve mund të financohen nga grante ose me kushte koncesioni me fondet e siguruar nga buxheti i shtetit dhe donatorët, me kosto shumë më të ulëta financimi.

4.5.2 Pa asnjë rregullim, ky dallim do të bëjë që të licencuarit të fitojnë një kthim të tepërt, që është i ngushtë me kostot aktuale të financimit që ata kanë, për arsye që janë jashtë kontrollit të menaxhimit. Për këtë arsye, aty ku asetet financohen nga burime koncesionare, ZRRE-ja do të rregullojë bazën e asetëve të rregullatorit së poshtmi, në mënyrë që kthimi i fituar të mos jetë i tepërt.

4.5.3 Këto rregullime do të raportohen në **llogaritë rregullatore**. ZRRE-ja do të njoftojë të licencuarit për rregullimet përkatëse që janë bërë në çdo rast.

## 4.6 Shpenzimet kapitale dhe shtesat

- 4.6.1 Të licencuarit duhet të sigurojnë një ndërprerje të **projekteve me shpenzime kapitale të mëdha**. Këta përcaktohen si projekte në të cilët shpenzimet kapitale totale i kalojnë €[3,000,000] ose [5]% të bazës së aseteve të rregullatorit, cilado qoftë më e madhe.
- 4.6.2 Shpenzimet kapitale mbi projektet me shpenzime kapitale të mëdha, grumbullohen gjatë periudhës së ndërtimit me kostot reale të hasura, dhe përfshijnë interesin e kapitalizuar gjatë ndërtimit, i cili është ngarkuar me koston mesatare të kapitalit që është aplikuar nga ZRRE-ja për të përcaktuar maksimumin e të ardhurave vjetore të lejuara për të licencuarin ose të licencuarit e tjerë. Këto shpenzime kapitale janë shtuar në bazën e asetit të rregullatorit në atë vit në të cilin është vënë në punë aseti shoqëruar
- 4.6.3 Shpenzimet kapitale për projektet e tjera i shtohen bazës së asetit të rregullatorit në vitin në të cilin janë bërë këto shpenzime.
- 4.6.4 Çdo e ardhur vjetore ose kontribut i palës së tretë, siç janë kontributet e konsumatorëve, do të balancohet (kompensohet) kundrejt vlerës së shpenzimeve kapitale që i janë shtuar bazës së asetit të rregullatorit.
- 4.6.5 Pas shqyrtimeve vijuese të çmimeve ose gjatë intervaleve të ndryshëm që përcaktohen nga ZRRE-ja, kjo e fundit mund të kërkojë rregullime për vlerën e shtesave të bazës së aseteve të rregullatorit, për të radhitur si duhet shpenzimet kapitale reale dhe ato të lejuara. Çdo rritje ose zvogëlim në vlerën e bazës së asetit të rregullatorit që rrjedh prej këtyre rregullimeve, do të trajtohet si një pagesë dëmtimi.

## 4.7 Kapitalizimi

- 4.7.1 Shpenzimet mbi asetet ekzistuese duhet të kapitalizohen nëse ato zgjasin jetën në mënyrë të dukshme, rrisin kapacitetin fitues ose përmirësojnë efikasitetin e aseteve në fjalë.
- 4.7.2 Në përgjithësi, parimet në vijim duhet të aplikohen për qëllime kapitalizuese:
- Të gjitha shpenzimet mbi zëvendësimin ose riparimin e linjave ajrore dhe kablove të nëndheshëm, duhet të kapitalizohen.
  - Të gjitha blerjet e mjeteve dhe pajisjeve me vlerë më të madhe se €3,000 duhet të kapitalizohen.
  - Të gjitha shpenzimet mbi Linjat në pronë jo-shtetërore (në ato private) dhe lehtësimet duhet të kapitalizohen.
- 4.7.3 Të licencuarit mund të devijojnë nga këto parime nëse ata mendojnë se kjo gjë mund të përputhet më mirë me parimet e përgjithshme në lidhje me kapitalizmin, siç përcaktohet në nën-seksionin 4.7.1. në raste të tilla, devijimi dhe justifikimi për këtë, duhet të identifikohet në deklaratën e **parimeve dhe politikave të kontabilitetit të rregullatorit**, që është dorëzuar nga i licencuari.

## 4.8 Zhvlerësimi (amortizimi)

- 4.8.1 Të licencuarit duhet të tregojnë afatin e qëndrueshmërisë mesatare të asetit, që është matur në përputhje me aksionin e çdo aseti sipas vlerës, që aplikohet në përcaktimin e

zhvlerësimit (amortizimit). Afati i qëndrueshmërisë i asetit të përdorur do të jetë ajo që aprovet nga ZRRE-ja për qëllime rregullatore.

4.8.2 Nëse ZRRE-ja ka miratuar një pagesë për renovimin e infrastrukturës në lidhje me asetet para vitit 2006, përlllogaritja e moshës mesatare të menduar të asetit, që është përdorur për qëllime zhvlerësimi (amortizimi), do t'i përjashtojë këto asete dhe do të bazohet vetëm në asetet pas vitit 2006.

4.8.3 Principe të mëtutjeshmë në lidhje me zhvlersimin mund të lëshohen nga ZRRE-ja

## 4.9 Alokimi i kostove, të ardhurave vjetore, asetëve dhe detyrimeve

4.9.1 Kostot, të ardhurat, asetet dhe detyrimet që nuk mund t'i atribuohen drejtpërdrejt një të licencuarit, ose midis aktiviteteve të rregulluara dhe atyre të pakualifikuara të të licencuarit, do të shpërndahen në përputhje me parimet që përfshihen në këtë seksion.

4.9.2 Kjo përfshin kosto të përbashkëta që kanë të bëjnë me të licencuarit të cilët janë pjesë e një ndërmarrjeje të integruar, përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm nga kostot e shërbimeve administrative, logjistike dhe mbështetëse.

4.9.3 Alokimi e aplikuar duhet të jetë në pajtim me parimet vijuese:

- Shkakësia. Baza e ndarjes së parave duhet të jetë ndarja ose përdorimi nga ana e të licencuarit, i aktiviteteve të cilat shkaktojnë krijimin e kostove ose detyrimeve në fjalë, të ardhurat vjetore që do të fitohen, ose asetet që do të blihen.
- Objektiviteti. Kriteri bazë i ndarjes së parave nuk duhet të favorizojë padrejtësisht të licencuarin ose ndonjë kompani apo organizatë tjetër.
- Përputhshmëria. Nëse është e praktikueshme, kriteri bazë i ndarjes së parave duhet të jetë i qëndrueshëm nga viti në vit.
- Transparenca. Kriteri bazë për ndarjen e parave duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm.

4.9.4 Për **artikujt jo të rëndësishëm të alokuar**, ose nëse kostot e ndarjes së kostove, të ardhurave vjetore, asetëve ose detyrimeve bazuar mbi shkakësinë, janë të tepërta në lidhje me vlerën e artikujve në fjalë, ndarja (caktimi) e parave mund të bëhet sipas ndonjë parimi tjetër të përshtatshëm, me përjashtim të përdorimit të metodave të shmangshme të kostove.

4.9.5 Për këtë qëllim, **një artikull i rëndësishëm i alokuar**, përcaktohet si një artikull me vlerë që e kalon shumën prej €[100,000] ose [0.5]% të qarkullimit (xhiros) të të licencuarit, gjatë vitit në të cilin janë bërë llogaritë rregullatore në fjalë, cilado qoftë më e madhe si shumë.

4.9.6 Nëse të licencuarit zgjedhin që të mos përdorin shkakësinë si bazë për caktimin për pagesë të një artikulli që konsiderohet si i rëndësishëm brenda kuptimit të dhënë në këtë seksion, ata duhet të regjistrojnë artikullin në fjalë, parimin e alokimit të përdorur dhe arsyet për përdorimin e këtij alokimi. Me kërkesë të ZRRE-së, këto regjistra do të vihen në dispozicion të saj.

## 4.10 Transaksionet e palës së përfshirë

4.10.1 Për qëllimin e **llogarive rregullatore, palët e përfshira** janë përcaktuar si:

- Vartës të të licencuarit;
- Sipërmarrje e ngushtë e fundit dhe ndërmjetësuese e të licencuarit, si dhe vartësve të tjerë;
- Ortakët dhe sipërmarrjet e përbashkëta në të cilat merr pjesë i licencuari dhe investitorë ose pjesëmarrës të tjerë;
- Ndërmarrje të tjera të cilët kanë të njëjtët individë kryesorë të menaxhimit së bashku me të licencuarin;
- Ndërmarrje të tjera që kontrollohen nga personat ose ndërmarrjet, të cilët veçmas ose së bashku, kontrollojnë edhe të licencuarin; dhe
- Entitetet që menaxhojnë ose menaxhohen prej të licencuarit sipas një kontrate menaxhimi, ose ndonjë marrëveshjeje të ngjashme.

4.10.2 Për këtë qëllim, individi ose ndërmarrja mendohet se ka kontroll mbi një ndërmarrje tjetër, në rast se ushtronjë më shumë se 20% të të drejtave votuese të kësaj të fundit.

4.10.3 Në rast se i licencuari blen mallra ose shërbime prej një **pale pjesëmarrëse**, i duhet të tregojë se:

- Çmimet e paguara për mallrat dhe shërbimet janë të arsyeshme;
- Nuk ekziston asnjë ndër-subvencion midis aktiviteteve të rregulluara dhe të pakualifikuara të të licencuarit dhe palës së përfshirë; dhe
- Mallrat dhe shërbimet nuk janë blerë me kosto shtesë sesa po të ishin siguruar brenda biznesit të të licencuarit.

4.10.4 Si minimum, nevojitet:

- Kontrata për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të jepen përmes një procesi tenderues konkurrues të drejtë dhe jo-diskriminues, në të cilin janë marrë tre ose më shumë oferta; ose
- Çmimi i paguar për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, duhet të bazohet në kostot reale të furnizimit, si dhe normën e duhur të kthimit mbi kapitalin e punësuar.

4.10.5 Do të jetë përgjegjësi e të licencuarit që të tregojë se janë përmbushur të gjitha këto kritere.

4.10.6 Të licencuarit duhet të regjistrojnë të gjithë **transaksionet e mëdha të palës së përfshirë** në **llogaritë rregullatore** që kanë dorëzuar. Për këtë qëllim, transaksioni i madh i palës së përfshirë përcaktohet si një transaksion ku, vlera vjetore e pagesave për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, i kalon €250,000.



A.1

## **Deklaratat Pro-forma të kontabiliteteve të rregullatorit**

**Deklaratat Pro-forma të kontabiliteteve të rregullatorit** sigurohen si dosje të veçanta elektronike në MS Excel. Kjo përfshin fletët vijuese të punës:

- 1 Kopertinë
- 2 Deklaratën e të hyrave
- 3 Bilancin
- 4 Deklaratën e rrjedhjes së parave të gatshme
- 5 Analiza e qarkullimit (xhiros)
- 6 Analiza e kostove të vënies në funksionim dhe të mirëmbajtjes
- 7 Baza e aseteve të rregullatorit (BAR)
- 8 Shpenzimet kapitale
- 9 Zhvlerësimi (amortizimi)
- 10 Mbetjet
- 11 Shtesat
- 12 Përmbledhje e projekteve madhore
- 13 Dispozitat
- 14 Transaksionet që kanë të bëjnë me palët
- 15 Alokimi (alokimi) e kostove të përbashkëta
- 16 Treguesit kryesorë financiarë

Të licencuarit duhet të printojnë dhe plotësojnë një paketë deklaratah **pro-forma të kontabilitetit të rregullatorit** të cilat duhet të përfshihen si pjesë e materialeve kopje të llogarive rregullatore që janë dorëzuar në përputhje me nën-seksionin 2.2.3.

## A.2 Shablloni për raportin e auditorëve ndaj rregullatorit

[fusni datën e raportit]

Për Kryesuesin e Bordit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë

### **Llogaritë rregullatore për periudhën e përfunduar më [fusni periudhën dhe datën]**

Ne kemi kontrolluar (audituar) Llogaritë rregullatore dorëzuar prej [fusni emrin e të licencuarit] ("i Licencuari") së bashku me Raportin Rregullator. Këto përfaqësojnë një raport financiar me qëllim të veçantë, i cili kërkohet të përgatitet në përputhje me kushtin [fusni numrin] e licencës së mbajtur nga i Licencuari dhe që është nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ("Zyra").

#### Përgjegjësitë përkatëse të Drejtorëve dhe auditorëve

Drejtorët e të Licencuarit janë përgjegjës për përgatitjen e Llogarive rregullatore. Përgjegjësia jonë është që të formojmë një opinion të pavarur mbi ato llogari, bazuar në kontrollimin (auditimin) tonë, dhe të raportojmë opinionin tonë tek ju.

Ky raport është përgatitur vetëm për qëllimet e përmbushjes së kriterëve të Zyrës, siç përcaktohet në Udhëzimet e Kontabilitetit të Rregullatorit, nxjerrë nga Zyra dhe nga i Licencuari, dhe nuk duhet përdorur për qëllime të tjera përveç atyre të specifikuara në të. Ne hedhim poshtë çdo supozim për përgjegjësinë ndaj çdo besimi në këtë raport, ose në Llogaritë rregullatore, prej çdo personi ose për çdo qëllim tjetër përveç atyre për të cilët dhe për çfarë është përgatitur.

#### Bazat e opinionit

Ne kemi udhëhequr kontrollin tonë në përputhje me Standardet Kosovare të Auditimit. Një kontroll (auditim) që bazohet në testim, përfshin ekzaminimin e dëshmimeve përkatëse për shumatat dhe hapjen (zbulimin) e tyre në deklaratat financiare të rregullatorit. Ai gjithashtu përfshin një vlerësim të shifrave dhe gjykimeve domethënëse që janë bërë prej Drejtorëve gjatë përgatitjes së Llogarive rregullatore, si dhe gjykimin nëse politikat aplikuar të kontabilitetit janë të përshtatshme për rrethanat e të Licencuarit, të aplikuar herë pas here dhe të hapura siç duhet.

Ne kemi lexuar informacionin tjetër që është përfshirë në Raportin Vjetor dhe deklaratat financiare të të Licencuarit, dhe kemi shqyrtuar përfshirjet e ndonjë deklarate të gabuar ose mospërputhshmërisë së dukshme të materialeve që mund të jenë bërë në raportin tonë, midis këtyre llogarive rregullatore dhe llogarive statutores të të Licencuarit.

#### Opinionit

Sipas mendimit tonë, Llogaritë rregullatore dhe informacionet e tjera përfshijnë informacione për periudhën e përfunduar [fusni datën e përfundimit të periudhës] që i nevojitet të Licencuarit për të përgatitur dhe për t'ju dorëzuar, në mënyrë që të jetë në pajtim me kushtin [fusni numrin] e Licencës që bartet nga i Licencuari.

Në lidhje me këtë informacion, ne raportojmë se sipas mendimit tonë:

- a) I Licencuari ka mbajtur/nuk ka mbajtur [fshini nëse ju duket e përshtatshme] regjistra të duhur të kontabilitetit.
- b) Informacioni është/nuk është [fshini nëse ju duket e përshtatshme] në përputhje me regjistrat e kontabilitetit të të Licencuarit, dhe është/nuk është [fshini nëse ju duket e përshtatshme] përgatitur siç duhet dhe në përputhje me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit që janë nxjerrë nga Zyra.
- c) Llogaritë rregullatore japin [sipas kualifikimeve të renditura më poshtë] një shqyrtim të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave, kostove, asetëve dhe borxheve të të Licencuarit, në përputhje me parimet dhe politikat e kontabilitetit që janë përcaktuar në Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit.

[Nëse auditori ka qenë i paaftë të japë një mendim të kualifikuar, atëherë duhet të jepet një deklaratë ku renditen karakteristikat e regjistrave të kontabilitetit, harmonia midis regjistrave të kontabilitetit dhe Llogarive rregullatore dhe baza e përgatitjes së Llogarive rregullatore, si dhe çdo çështje tjetër që mund të krijojë ndonjë dallim të madh midis Llogarive rregullatore dhe një shqyrtim të drejtë të pozicionit financiar të të Licencuarit]

I juaji sinqerisht,

[fusni emrin e auditorit]

[fusni emrin e nënshkruesit]

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

---

Anëtarët e Bordit të ZRRE-së

---

---

---

---